

dokumentacionit kryhet nga ora 10:00 – 16:00 pranë Sekretarisë së KIZ (Sektori Juridik në Rektorat).

1.3 Afati i aplikimit për regjistrimin e kandidatëve përfaqësues të studentëve në Senatin Akademik fillon në datën 03.07.2020 dhe përfundon në datën 07.07.2020 ora 16:00. Dorëzimi i dokumentacionit kryhet nga ora 10:00 – 16:00 pranë Sekretarisë së KIZ (Sektori Juridik në Rektorat).

2. Të miratojë dokumentacionin përkatës për kandidim për rektor, anëtarë të Senatit Akademik, drejtues të njësisë bazë, drejtues të njësisë kryesore, si dhe përfaqësues i studentëve në Senatin Akademik, sipas formateve bashkëlidhur këtij vendimi.

2.1 Dokumentacioni i nevojshëm që duhet të dorëzohet në Sekretarinë e KIZ kandidatët për rektor, anëtarë të Senatit Akademik, drejtues të njësisë kryesore, si dhe drejtues të njësisë bazë është:

- Kërkesa për kandidim (formulari i kandidimit për personel akademik);
- Vetdeklarimi për mungesën e plagjiaturës (Formulari për mungesën e plagjiaturës);
- Vetdeklarimi që kandidati nuk ka fituar dy mandate sipas ligjit 9741, datë 21.05.2017, nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale, si dhe nuk është objekt i ligjit 138/2015 dhe ligjit 45/2015 (Formulari përkatës);
- Kopje e dokumentit të identifikimit;
- Kopje e gradës/titullit ose kopje e noterizuar për kandidatët që vijnë jashtë UPT – së;
- Dokumenti që vërteton vendin ku është i punësuar kandidati;
- Vërtetim nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore që ndaj kandidatit nuk është dhënë masë disiplinore.

2.2 Dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga studentët kandidatë për anëtarë të Senatit Akademik është:

- Kërkesë për kandidim (formulari i kandidimit për studentë);
- Kopje e dokumentit të identifikimit;
- Vërtetimi që është student me kohë të plotë në UPT;
- Dokumentin që vërteton se është student i ekselencës ose me notë mesatare të ponderuar deri në momentin e kandidimit mbi 8 (lista e notave);
- Propozimin nga jo më pak se 30 studentë pjesë e trupës zgjedhore. Mbështetja për kandidatin shprehet përmes plotësimit të formularit të mbështetjes së kandidatit, i cili së bashku me një kopje të kartës së identitetit ose kartës së studentit, dërgohet me e-mail në adresën [kiz2020@upt.al](mailto:kiz2020@upt.al) deri më datë 07.07.2020 ora 16:00.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Gjergji Islami

Kryetar

Bexhet Kamo

Anëtar

